

KËRKESË

Nr. 6594/6, datë 28.10.2020

PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “tokë arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Bashkisë Tiranë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit, nga shpronësimi, në shumën 1 819 356 (një milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, DHE/OSE SHKËMBEHEN, PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR “ZONË TË RE PËR ZHVILLIM”, NJËSIA ADMINISTRATIVE ZALL-HERR, BASHKIA TIRANË

Nr.	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Vlerësimet për shpronësim dhe/ose kompensim sipas llojit të pasurisë			Vlera totale (lekë)	Kompensim në vlerë/shkëmbim	Konfirmuar/shënime	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. arë totale m ²	Shpronësim tokë “arë”					Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, e ASHK-së	Shënime në kartelë
								Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)				
PRONË PRIVATE														
1	Gëzim	Asllan	Boka	3878	86/40	Arë	3,280.0	1,129	231	260,799	260,799	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
2	Qemal	Rexhep	Lazi	3878	86/8	Arë	3,200	3,200	231	739,200	739,200	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
3	Qemal	Rustem	Boka	3878	86/7	Arë	3100	2,917	231	673,827	673,827	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
Kompensimi në vlerë (lekë)				Sip. e prekur në m²				7,246			1,673,826			
Pa informacion nga ASHK-ja														
1	Pa informacion			3878	339			630	231		145,530	Kompensim në vlerë	Shkresa nr. 6362/2 prot., datë 14.9.2020.	
Kompensimi në vlerë (lekë)				Sip. e prekur në m²				630			145,530			
SHTET														
1	Shtet			3878	86/26	Arë	9,320.00	9320	0		0		Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
2	Shtet			3878	86/12	Arë	390.00	390.00	0		0		Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
3	Shtet			3878	86/11	Arë	695.00	695.00	0		0		Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
4	Shtet			3878	86/9	Arë	3100	3,100.00	0		0		Shkresa nr. 6362 prot., datë 10.9.2020.	
Sip. e prekur për pronën shtet në m²								13,505.00						
Totali i kompensimi në vlerë (lekë)				Sip. e prekur në m²				21,381.00			1,819,356.00			

Shënime.

- Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresat nr. 6362 prot., datë 10.9.2020 dhe nr. 6362/2 prot., datë 14.9.2020, të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1, të ASHK-së.
- Për vlerësimin e pasurive të llojit truall i jemi referuar VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.